KOLEGJI UNIVERSUM




# MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

KOLEGJIT "UNIVERSUM"

DHE

ODA E INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS "OIK"

Prishtinë, Shtator 2022

KOLEGJI UNIVERSUM

Kolegji Universum dhe Oda e Infermierëve, Mamive, dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë (OIK), me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit afatgjatë, lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, dhe pajtohen, që të respektojnë qëlllimin e kësaj marrëveshje të bashkëpunimit si më poshtë:

## NENI I
## PALËT NËNSHKRUESE

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi (tash e tutje: Memorandum) lidhet ndërmjet Kolegjit Universum - (tash e tutje: KU), dhe Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë "OIK" (tash e tutje: Oda).

2. Kolegji Universum " i përfaqësuar nga themeluesi Alejtin Berisha.

3. Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë, e përfaqësuar nga Kryetari Naser Rrustemaj

## NENI II
## QËLLIMI

1. Palët (Kolegji Universum - më tutje KU, dhe Oda e Infermierëve, Mamive, dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë (më tutje OIK) do të zhvillojnë në të gjitha format përkatëse bashkëpunimin në kuadër të fushëveprimtarive të veta

2. Të dy palët do të angazhohen që të ndërtojnë lidhje të qendrueshme në shkëmbimin e pervojave, realizimin e trajnimeve profesionale në fushën e arsimit, sensibilizimit dhe shëndetësisë, si për shembull, organizimi i trajnimeve të ndryshme për student dhe profesionistë shëndetësorë.

KOLEGJI UNIVERSUM

OIK

## NENI III

## FUSHËVEPRIMI

1. Ky Memorandum vendos lidhur me natyrën, nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit mes të Kolegjit Universum dhe OIK.

2. Ky Memorandum, poashtu vendos edhe lidhur me procedurat, kushtet dhe kriteret për lehtësimin e shkëmbimit të informacioneve në interes të ndërsjellë.

3. Dispozitat e këtij memorandumi, poashtu edhe kërkesat e tjera ligjore duhet respektuar nga të dy palët nënshkruese.

## NENI IV

## ZOTIMET DHE DETYRIMET E PALËVE LIDHUR ME KONFIDENCIALITETIN

1. Të dy palët zotohen të shqyrtojnë çdo kërkesë që i bëjnë palës tjetër, që të sigurohen se kërkesa është e arsyetuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi.

2. Të gjitha të dhënat, informacionet dhe dokumentet zyrtare, të cilat vihen në dispozicion nga palët nënshkruese, do të përdoren vetëm për qëllime të aktiviteteve zyrtare dhe për çdo shpalosje të paautorizuar e cila mund të bie ndesh me legjislacionin në fuqi, për mbrojtjen e të dhënave, përgjejgjësinë do ta mbajë secila palë për veten e saj.

3. Informacionet e pranuara sipas këtij Memorandumi, janë të natyrës së besueshme dhe do të përdoren vetëm për qëllimet e parapara me këtë Marrëveshje dhe, nuk mund të bëhet asnjë përdorim tjetër ose shpërndarje e informative, pa konsultim paraprak dhe autorizim me shkrim të palës që i ofron informata.

KOLEGJI UNIVERSUM

## NENI V

## OBLIGIMET E PËRBASHKËTA TË PALËVE

1. Palët do të mbështesin projektet reciproke, si dhe do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta, në atë mënyrë që bashkarisht të realizojnë projekte nga fusha e këtij Memorandumi (Trajnime, Seminare, Konferenca, Tryeza Diskutimi, Kampanja senzibilizuese etj).
2. Me theks të veçantë do të afirmohet avancimi i shërbyesve shëndetësore, me subjektetet (entitetet) kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e lartëpërmendura.
3. Palët nënshkruese, pajtohen që do të formojnë një Grup të përbashkët punës, i cili do të ketë për detyrë që, fillimisht t'i identifikojë, e më pastaj edhe ti zbatojë format e këtij bashkëpunimi.
4. Palët do të bashkëpunojnë edhe në fushën e sensibilizimit, vetëdijësimit dhe organizimit të qëllimeve të lartë cekura, ku do të tentohet që profesionistëve shëndetësorë, t`iu mundësohet ngritja profesionale dhe avansimi personal i vazhdueshëm, me qëllim që të njejtit të mund t`iu përgjigjen me përgjegjshmëri të plotë problemeve që u lindin në punë.

## NENI VI

## OBLIGIMET E ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË SHËNDETËSORË (OIK)

1. Oda do të vendosë logon dhe stemën e Kolegjit Universum në të gjitha materialet promovuese, duke përfshirë ato online, por edhe ato fizike, me qëllim që të bëhet identifikimi i lehtë i tyre.
2. Oda obligohet që në të gjitha dokumentet, çertifikatat apo çfardo materiali tjetër të vendosë në pjesën ballore llogon e Kolegjit Universum, në atë mënyrë që të bëhet qartësisht e dukshme kjo gjë.

KOLEGJI UNIVERSUM

OIK

## NENI VII

## OBLIGIMET E KOLEGJIT "UNIVERSUM"

1. Kolegji Universum do të ofrojë programet të cilat akreditohen nga OIK për profesionistët shëndetësorë lidhur me simpoziumet e ndryshme të organizuara nga stafi akademik i kolegjit si dhe trajnime të tjera brenda dhe jashtë vendit, si p.sh. Edukimi dhe trajnimet e vazhdueshme 3 ditore, 3 mujore deri 3 vjeçare, brenda dhe jashte Republikës së Kosovës.

2. Kolegji Universum do të përkrah OIK në proceset e integrimeve evropiane në oda si motra dhe në përmbushjen e kritereve të stabilizim asocimit me programet e ngjeshura të trajnimit më të gjatë për infermier në nivele të ulta të shkollimit.

3. Specifikisht Kolegji Universum do i ofrojë Odës mbështetje në realizimin e këtyre programeve:

- ✓ Programin për lidhje të qendrueshme në shkëmbimin e përvojave, realizimin e trajnimeve profesionale në fushën e sigurisë, sensibilizimit dhe shëndetësise.
- ✓ Programin për aftësim profesional të profesionistëve shëndetësore në "Simpoziume dhe trajnime" nga trajnerë me licensë vendore dhe ndërkombëtare.
- ✓ Programin Edukimi dhe trajnimet e vazhdueshme 3 ditore, 3 mujore deri 3 vjeçare, brenda dhe jashte Republikës së Kosovës.

## NENI VIII

## REGJISTRIMI I PJESËMARRJES NË AKTIVITET

1. Regjistrimi i pjesëmarrësve në trajnime, do të bëhet nga ana e përfaqësuesit të Kolegjit Universum në atë mënyrë që, nën vëzhgimin e tij do të regjistrohen dhe nënshkruhen në fillim dhe përfundim të çdo trajnimi.
2. Lista e aktiviteteve dhe pjesëmarrësve në mënyrë konfidenciale do të ruhet në dy kopje autentike për dy palët nënshkruese.

KOLEGJI UNIVERSUM

## NENI IX

## ÇERTIFIKIMI I PJESËMARRËSVE

1. Pjesëmarësit do të pajisen me çertifikata përkatëse, në atë mënyrë që, të gjithë pjesëmarrësit e rregullt do të kenë të drejtën për këtë gjë.
2. Pjesëmarrësit, të cilët nuk e kanë ndjekur trajnimin në mënyrë të vazhdueshme dhe me ndërprerje, për shkak të natyrës specifike të trajnimeve, nuk do të kenë të drejtë për çertifikim, por të njejtit, duhet të ndjekin trajnimin nga fillimi në mënyrë që të çertifikohen.
3. Çertifikimi do t`iu shërbejë profesionistëve shëndetësorër me qëllim që të njejtit ta shftytëzojnë atë për arritjen e pikëve akredituese profesionale.

## NENI X

## LLOJLLOJSHMËRIA E AKTIVITETEVE PROFESIONALE

1. Në kuadër të këtij memorandumi do të zhvillohen dy lloj aktivitetesh, aktivitete teorike të tilla si: Konferenca, Trajnime, dhe Ëorkshope brenda dhe jashtë Kosovës.
2. Aktivitete Praktike në kuadër të fushëveprimtarive të cekura si në nenet më lartë.

## NENI XI

## VLERËSIMI DHE ANALIZIMI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE

1. Palët nënshkruese konform obligimeve që rrjedhin nga ky Memorandum, brenda afatit 7 ditor nga mbajtja e çdo aktiviteti do të bëjnë analizimin e arritjes së objektivave që i synon kjo marrëveshje.
2. Kolegji Universum obligohet që, në vazhdimësi brenda afatit të lartëcekur të bëjë dorëzimin e raporteve me shkrim në lidhje me vijueshmërinë e aktiviteteve.

KOLEGJI UNIVERSUM

## NENI XII

## FILLIMI, ZGJËRIMI DHE MBARIMI I BASHKËPUNIMIT

1. Memorandumi do të jetë në fuqi nga dita e nënshkrimit deri në përfundimin e programit, ose deri sa të zëvëndësohet me ndonjë program apo marrëveshje tjetër.

2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila palë, më kusht që paraprakisht të ketë njohtuar me shkrim palën tjetër, të paktën 30 ditë më parë, ndërsa mund të plotësohet apo edhe ndryshohet pjesërisht apo tërësisht, me vullnetin e palëve pas pajtimit me shkrim në mes tyre për ta bërë këtë gjë.

3. Palët pajtohen që, në lidhje me të gjitha mosmarrëveshjet në fuqi t`i zgjidhin brenda 30 ditëve me mirëbesim.

4.. Autorsia dhe programi i trajnimeve mbetet e mbrojtur nga Kolegji Universum.

## NENI XIII

## GJUHA DHE KOPJET E MARRËVESHJES

1. Ky Memorandum është i shkruar dhe lexuar në gjuhen shqipe dhe gjuhën angleze. Në rast se ka mos përputhje, meret parasysh memorandum në gjuhën shqipe.
2. Ky Memorandum është i formuluar në 4 kopje origjinale, me nga 2 kopje për secilën palë nënshkruese .

**Kolegji UNIVERSUM**

Alejtin Berisha

Drejtor Ekzekutiv

Dt. 16.09.2022

**Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë**

Naser Rrustemaj

Kryetar i OIK

Dt. 16.09.2022